



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.46/2017

Prishtinë, më 30 janar 2017

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyqi dhe Kujtim Paqaku.

Mungoi: Nenad Rashiq.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinatori i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës, Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit (UNICEF).

Pjesëmarrës të tjerë: Prenkë Gjetaj-ZKM KQPZH, Kushtrim Gara- ZKM KQPZH, Xhemile Morina-ZKM KQPZH, Nehat Dervishi-OSCE, Teuta Prekazi-UNMIK HUMAN RIGHTS, Fitore Ademi-RTV 21, Eugen Cakolli-KDI dhe Jelena Gjorgjovic-RTK 2.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit, andaj në vazhdim, Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Informata e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur,
2. Diskutimi lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur.

1. Informata e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur,

Kryetarja, tha se kem i prezent Kryesuesin e Komisionit Qeveritare për Persona të zhdukur z.Prenk Gjetaj dhe z.Kushtrim Gara, për te na Informuar për ecurit e punëve për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur si dhe për te diskutuar për plotësim ndryshimin e Ligjit për Persona të zhdukur.

Prenk Gjetaj- çështja e personave të zhdukur është një temë mjaft komplekse që nuk varet vetëm nga puna e komisionit por nga të gjithë partnerët që janë të involvuar në proceset e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur si vendor ashtu edhe ndërkombëtare, ne mund të jua prezantojmë shkurt një pjese të punës nga raporti i cili prezanton punën e komisionit dhe mund të ua dërgojmë edhe në formë elektronike, por po bëjë një prezantim të shkurtër të aktiviteteve që janë zhvilluar gjatë vitit 2016, komisioni ka vazhduar në mbajtjen e takimeve të rregullta me të gjithë aktorët vendor dhe ndërkombëtare të angazhuar në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur, kemi marrë pjesë edhe në dy takime rajonale, janë mbajtur edhe tri takime të grupit punues për persona të zhdukur me Serbinë me ndërmjetësimin e Kryqit të Kuq ndërkombëtare, në këto takime të grupit punues delegacioni i Kosovës ka iniciuar të paktën edhe dy raste të reja, Palët janë pajtuar që në kuadër të nëngrupit punues të funksionoi edhe ekipi për analiza të dokumenteve. Në muajin mars të vitit të kaluar një delegacion i mbretërisë së bashkuar i kryesuar nga Princi Carlls, i cili ka vizituar vendin tonë dhe ka takuar edhe Komisionin Qeveritar për Persona të zhdukur duke bërë homazhe të lapidari që u dedikohet personave të zhdukur në Kosovë, si rezultat i kësaj vizite muajt e fundit ka filluar implementimi i një projekti të ambasadës Britanike përmes të cilës përkrahet Qeveria e Jonë në trajtimin e çështjes së personave të zhdukur dhe mundësisë për rritje të rezultateve në këtë proces, zbatim të planit vjetore të qeverise. Gjate kësaj periudhe ekspertët mjekoligjor vendor dhe ndërkombëtarë (EULEX), të Institutit të Mjekësisë Ligjore, kanë realizuar më shumë se 20 operacione fushore ose aktivitete gërmuese të realizuara në 15 lokacione të shënuara në kërkim të mbetjeve mortore të viktimave të luftës si pasoje e luftës së vitit 1998-1999, në disa komuna të Kosovës, nga 15 lokacione të proceduara në territorin e Kosovës gjatë këtij viti me gjetje mortore të viktimave të luftës kanë rezultuar vetëm 6 lokacione, ku janë zhvarrosur mbetjet mortore të 7 personave. Edhe gjatë këtij vitit ekspertet e mjekësisë ligjore në emër të delegacionit të Kosovës kanë marrë pjesë edhe kanë dhënë kontributin e nevojshëm në gërmimet vlerësuese në Serbi në lokacionin e Kishevakut, komuna e Rashkës. gërmimet vlerësuese janë ndërpre nga ana e Institucioneve të Serbisë, për të vazhduar në vitin e ardhshëm, deri tash këto punime janë ndërpre katër herë, ky lokacion është iniciuar nga Prokuroria serbe. Aj tha se sipas Ligjit i cili përfshin periudhën e luftës janar 1998 dhe 31 dhjetor 2000, janë aktualisht si te zhdukur 1660 persona.

Lirije Kajtazi-tha se ishin informata që i nevojiten komisionit, neve si komisionin na duhet të dimë edhe cilat nene është e nevojshme të ndryshohen dhe plotësohen në ligjin e Personave të zhdukur, për ti bërë institucionet me të përgjegjshme dhe të trajtohen familjarët e personave të zhdukur më dinjitetëshëm.

Prenk Gjetaj, secili institucion që merret me këtë çështje ka nevojë për përkrahje, ky proces nuk është krejt në dorën tonë, varemi edhe nga institucione të tjera, jemi në procedurë të hartimit të planit të veprimit për vitin 2017, këtë plan nëse e bëjë pa koridrim me institucionet tjera profesionale sigurisht se do të jetë i pazbatueshëm, për shkak se nganjëherë ka mungesë

kapaciteteve profesionale, prej pasluftës kemi një lokacion të shënjuar e të dyshuar për një varrezë masive që mundë të jetë në Mitrovicën Veriore gjegjësisht menjëherë te Ura e Ibrit në vendin e xhamisë së Ibrit, xhamia është djeg, vazhdimisht insistimi i ynë ka qenë të gërmohet aj lokacion, nga viti 2010 ka ekzistuar një urdhërese e gjykatës për tu gërmuar dhe vlerësuar aj lokacion, ne nuk kemi pasur njohuri për këtë, këtë e marrim vesh në nëntor 2016, kur është kërkuar urdhëresa e re, ky gërmim shtyhet me vendim të autoriteteve të EULEX-it, për arsye politike.

Mexhide Mjaku-Topalli, bëri pyetje se nga kush është mbajtur peng kjo urdhërese e gjykatës?

Prenk Gjetaj, urdhëresën e ka lëshuar Gjykata atëherë kur kanë qenë të EULEX-it, kur kërkohet urdhëresë, atëherë na thuhet se ekziston një urdhëresë e mëhershme dhe nuk ka nevojë të përsëritet, megjithëse urdhëresat gjyqësore për gërmime janë të afatizuara, mirëpo për çështjen e personave të zhdukur ka tolerancë, në atë kuptim për mos ta penguar procesin. Sa i parkete Ligjit për Personat e Zhdukur në radhë të parë ka vërejtje nga familjarët dhe propozoj që ju si anëtare të komisionit parlamentare ti dëgjoni drejtpërdrejt përfaqësuesit e familjeve dhe shoqatat që kanë familjare të zhdukur.

Teuta Haxhiu, tha se ka disa pyetje, kërkesa jonë është që me fillua plotësim ndryshimin e Ligjit, dhe se vërejtjen e parë e ka në termin viktimë civile që është në ligj, ndërsa që të gjithë nëpër fjalime e përdorim martirë, jam kundër këtij termi sepse këta nuk janë viktima civile, më intereson të dijë ku janë mbajtur takimet e grupeve punuese mes Kosovës dhe Serbisë, cilat kanë qenë kërkesat për rastin e lokacionit në Rashkë, a keni bërë kërkesë që tema e personave të zhdukur të hapet në Bruksel në bisedimet Kosove Serbi, çka keni bërë si qeveri për moszbatimin e urdhrit të gjykatës për gërmime në veri të Mitrovicës të xhamia e Ibrit, çka mund të bëhet në plotësim ndryshimin e këtij ligji dhe para 27 prillit ditës së të pagjeturve në Kosovë na me dal me fillimin e ndryshimit të këtij ligji. Me intereson problemi që është nëpër komuna me dokumntacione e sidomos në komunën e Pejës është shumë e evidentuar, a ekziston një dokument që e verifikon saktë, sepse vijnë familjarë prej Serbisë në Pejë dhe thoin se një familjar i tyre është i zhdukur në luftë, sado qe nuk ka asnjë dokument, ai mund të ketë pasur vdekje të natyrshme dhe aj e paraqet si të pagjetur nga lufta, a keni një regjistër të saktë.

Salihe Mustafa, tha se kemi nevojë për informata sidomos për plotësim ndryshim të ligjit për persona të zhdukur, me siguri do të kemi bashkëpunim edhe me shoqatën e familjareve të personave të zhdukur, të cilët do të japin kontributin e vet për këtë ligj dhe besoj se me punën që do ta bëjmë do të ju ndihmoj institucioneve në të ardhmen për ndriçimin e fatit të personave të zhdukur. Sa u përket mungesës së antropologëve, me sa dijë janë nga mjekësia ligjore të përcaktuar dy mjek profesionistë që të avancohen në këtë drejtim me siguri edhe për këtë do të na përgjigjeni se cilat janë shkaqet që nuk po avancohen.

Mexhide Mjaku-Topalli, është për tu përshëndetur takimi me ambasadorin Britanik, ai ka shprehur vullnetin për të fuqizuar kapacitetet për të trajtuar në mënyrë efikase çështjet që kanë të bëjnë me personat e pagjetur, po ashtu për të ndihmuar në ndryshimin e ligjit dhe për të krijuar mekanizma më të mirë për të identifikuar personat e pagjetur, për çka ka menduar aj që të krijoj mekanizma tjerë kur veç janë mekanizmat ekzistues, ajo pyeti se sa takime keni pasur

me përfaqësuesit e qeverisë së Britanisë pas lanësimit të projektimit, çfarë përmbajtje ka ky projekt dhe sa takime keni pasur. Raporti i progresit thotë se mungon koordinimi mes komisionit qeveritar dhe departamentit të mjekësisë ligjore, është vënë edhe një kërkesë në këtë raport që çevreja duhet të emëroj një mbajtës të skedarëve për çështjen e personave të pagjetur, çfarë funksioni ka ky person.

Mytaher Haskuka, tha se para luftës personi i zhdukur nuk është identifikuar me anë të analizës së ADN-së, dhe mundet të ketë pasur gabime në identifikim dhe keni thënë se duhet të bëhet rishikimi dhe të vërtetohet me anë të analizës së ADN-së, a është punuar në këtë drejtim, dhe për lokacionin e xhamisë së Ibrit, nga kush mundemi me kërkua ne si deputet përgjegjësi pse nuk është vepruar tek lokacioni i kësaj xhamie komfor urdhrit të gjykatës, me sa dijë aty janë bërë edhe ndërtime, sa i përket ndryshim plotësimit të ligjit për persona të zhdukur a mundeni të na tregoni se cilat janë pikat kyçe që duhet të ndryshohen që ligji të jetë më i mirë dhe më i zbatueshëm.

Mexhide Mjaku-Topalli, kohëve të fundit nëpër portalet është paraqitur drejtoresha e qendrës për studime euroatlantike Jelena Miliq, e cila ka përmendur varrezat e shqiptarëve në Serbi, ka qenë në debat edhe me kryeministrin e Serbisë, ajo e ka lëshuar studion duke marr kërcënime nga ai se kinse po flet kundër interesave të Serbisë, a keni menduar se është mirë të takohet dikush me këtë zonjë dhe të merrni informata nga ajo.

Shukrije Bytyqi, tha se e kuptojmë pozicionin që ju gjendeni por nuk e kuptojmë mos gatishmërinë e qeverisë që të paktën ju mos të keni pengesa në aspektin financiar, mendojmë se për këtë kategori është bere pak duke e ditur që është dhimbje veçanërisht për familjarët dhe kësaj çështje është dashur ti ipet prioritet edhe në bisedimet në Bruksel, deri në gjetjen e personit të fundit, shqetësuese është moslejimi i gërmimit në lokacionin në Mitrovicën e Veriut, po ashtu më intereson çështja e Profesor Ukshin Hotit, përderisa ka emra dhe adresë se kush e ka marrë, ku ka shkua, a keni kontaktua ndonjëherë me ata persona për të ditur më shumë për fatin e tij, shqetësuese ishte fshehja e urdhërësës së gjykatës nga viti 2010 deri 2016 për gërmime tek xhamia e Ibrit.

Etem Arifi, tha se pothuajse të gjitha këto që u than sot, janë thënë edhe vitin e kaluar në takim, është shqetësuese çështja e urdhërësës së gjykatës nga viti 2010, dhe komisioni qeveritar ketë e kupton në vitin 2016, sipas Raportit të Progresit dhe asaj çka ju na informoni, asgjë nuk ka lëvizur pozitivisht lidhur me fatin e personave të pagjetur dhe ku është problemi për këtë.

Kutjim Pacaku, tha se nga prezantimi i Kryetarit Gjeta, dëgjova dy probleme kyçe, siç ishte mungesa e mjeteve materiale që nuk guxon të ketë mungesë të mjeteve për këtë kategori dhe mungesa kuadrove profesionale dhe teknike, për 18 vite nuk mundem të krijojmë antropologë të duhur, a mendoni se në të ardhmen duhet të krijojmë urgjentisht këto kapacitete, aj përmendi edhe rastin e Profesor Hotit, që është liruar me 5 maj 1999, nga burgu dhe më nuk dihet asnjë informatë për fatin e tij.

Lirije Kajtazi, tha se nga kjo del se qëllimi ishte tek plotësim ndryshimi i ligjit për personat e zhdukur, kemi takuar edhe bashkë familjarët e personave të zhdukur që kemi biseduar për shumë çështje, dhe se çka mundemi të bëjmë më tepër, a duhet të kalohet diçka më shume nga

ndërkombëtare tek vendoret, a duhet më shumë vëmendje, më shumë buxhet dhe profesionalizëm, krejt këto janë çështje që i ofron ligji, por, situata është e komplikuar me shifrat e fundit.

Prenk Gjetaj – theksoi se ai ka sjellë para Komisioni një prezantim për ta pasur me të qartë çështjen sepse a i përket raportimit ai tha se Komisioni Qeveritar i raporton Qeverisë së Kosovës. Sa i përket terminologjisë së përdorur në ligj ai tha se janë të obliguar që ta respektojnë terminologjinë që është e përcaktuar në ligj pavarësisht diskutimeve të tjera. Ndërsa, sa i përket termit viktimë apo martir ai theksoi se edhe vet e përdor termin martirë mirëpo në instancën e fundit ata janë viktime.

Teuta Haxhiu – kërkoi sqarime nga z. Prenk Gjetaj sa më e arsyeshme është përdorimi i termit viktime civile apo martir.

Prenk Gjetaj – duke u ndërlidhur me parafolësen theksoi se ai është për termin i Zhdukur sepse atë e kanë përcaktuar me ligj. Në vazhdim ai ishte i pajtimit me mendimin që çështja e personave të zhdukur të futet në agjendën e bisedimeve në mes palës Shqiptare dhe asaj Serbe. Lidhur me çështjen e hulumtimeve në regjionin e Mitrovicës ai theksoi se janë bërë dy hulumtime në Regjionin e Mitrovicës duke specifikuar edhe Leposaviqin dhe Zubin Potokun si komunat më veriore të Kosovës dhe tha se nuk kanë pasur pengesa gjatë kryerjes së hulumtimeve rreth varrezave masive. Në këtë drejtim ai theksoi se do t jenë bashkëpunues me institucione dhe organizatat e tjera si dhe me familjarët e të pagjeturve me qëllim të gjetjes së lokacioneve të dyshuara për varreza masive. Lidhur me mbajtësin e dosjes ai tha se në raportin e punës theksoi se nuk e din kush e ka cek këtë emërtim mbajtës i dosjes. Lidhur me këtë ai tha se Kryesuesi i Komisionit Qeveritar është i emëruar nga Kryeministri dhe i raporton Kryeministrit, ai tha se nuk ka nevojë që të ndërmjetësojë dikush ndërmjet tyre dhe Kryeministrit sepse këta drejtpërdrejtë i raportojnë Kryeministrit dhe i raportojnë atij. Sa i përket çështjes së analizës ai tha se janë në vazhdimësi duke përmendur hartimin e një strategjie. Ai përmendi se një numër i personave që janë identifikuar me metoda klasike që kanë mundur të rezultojnë të gabuara dhe janë duke tentuar që të ndryshojnë këtë qasje në mënyrë të evitimit të problemeve. Lidhur me çështjen e informatorëve ai tha se në vazhdimësi kanë kontaktuar me informatorë me qëllim të identifikimit të vendit të saktë për gjetjen e trupave. Në çështjen e pozitës sociale ai tha se kjo varet nga ligjet e tjera. Sipas tij kompetencat e tij janë ekskluzivisht në zbatimin e ligjit të caktuar. Lidhur me kërkesën e Prof Ukshin Hotit ai tha se në çdo takim është ngritur kjo kërkesë mirëpo akoma nuk ka një informacion të saktë për këtë.

Mytaher Haskuka – pasi e falënderoi për përgjigjet e dhëna, e pyeti z. Gjetaj se çka duhet të ndryshohet te ligji aktual që është pengesë e në punën e Komisionit.

Prenk Gjetaj – Theksoi se duhet të ndryshoj fillimisht përfshirja kohore sepse ka raste të zhdukjeve gjatë viteve të ndryshme. Pastaj ai përmendi statusin e familjarit të pagjetur i cili është gjetur. Po ashtu përmendi edhe çështjet sociale të familjarëve mirëpo për këtë tha se më mirë do të jetë takimi me familjarët.

Kushtrim Gara – duke u ndërlidhur më këtë çështje theksoi se ka probleme rreth zbatimit të Ligjit për persona të Zhdukur mirëpo e theksoi se Kosova qëndron mjaft mirë në këtë çështje. Sa i përket përmbajtjes së ligjit ai theksoi se do të jetë e nevojshme që të grumbullohen në një ligj të gjitha çështjet që rregullohet edhe me ligje të tjera mirëpo që i prekin interesat e kësaj kategorie të personave sepse me mire do të jetë ekzistenca në një ligj të vetëm. Ai e përmendi çështjen e Xhamisë së Ibrit sipas të cilit kjo çështje është riaktualizuar në agjendën e tyre dhe

pasi që janë marrë informacionet e duhura ata kanë marrë një urdhëresë nga EULEXI sipas të cilit kjo çështje është e tyre sepse është inicuar nga ata. Lidhur me rastet që janë identifikuar pa analizën e ADN-së. Ai për këtë theksoi se nuk d.m.th se të gjitha këto raste janë gabim edhe pse janë identifikuar pa analizën e ADN-së. Ai po ashtu theksoi se edhe rasti i Pro Ukshin Hoti dhe raste të tjera janë raste që janë në agjendë dhe pritet që në vazhdim të ketë konkretizime.

Lirije Kajtazi – theksoi se çështja e familjarëve të personave të zhdukur nuk lidhet vetëm me ndryshimin e Ligjit për persona të Zhdukur por edhe me ligje të tjera që e prekin këtë çështje e që i tejkalon kompetencat e Komisionit për të Drejtat e Njeriut. Lidhur me këtë çështje ajo tha se shpreson se brenda tre mujorit të parë do të lëvizin me çështje konkrete.

Kushtrim Gara - tha se duhet që në plotësimet e Ligjit për personat e Zhdukur të futet data e 27 Prillit si dita e personave të zhdukur.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 15:30.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Lirije KAJTAZI